

# **STATUTI I SHOQËRISË dhe AKT THEMELIMI**

## **Smart Power Systems Shpk**

Sot me date 07/12/2024, ne perputhje me:

- Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
- Ligjin nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit"

Z. Edmond Lulzim Murja lindur me **29.03.1988** ne Selane, Peshkopi, Diber ,madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar ,

Z. Artur Agim Pjeshka, i lindur me **16.02.1992** ne Tirane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Themelojne ne cilesine e Ortakeve te Shoqerise, Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **Smart Power Systems Shpk** me permbajtjen si me poshte vijon:

## **KAPITULLI I FORMA; KOHËZGJATJA; ZYRA QENDRORE; OBJEKTI**

### **Neni 1: Forma Juridike**

Shoqeria **Smart Power Systems Shpk**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga personat fizik te siperpermendur, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara

### **Neni 2: Kohezgjatja**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pakufizuar qe fillon prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar, pranë Qendres Kombetare te Biznesit (me poshte referuar si QKB).

Ne perputhje me kete statut, shoqeria mund te pezulloje ose mbylle veprimtarine e saj kur e shoh te arsyeshme, apo ne rastet e parashikuara nga ligji.

### **Neni 3: Zyra Qendrore**

Zyra Qendrore e Shoqerise ndodhet ne adresen:

**Rruga Kongresi i Manastirit, Ndertesha 46/8, Shkalla 1, Ap 8 Tirane**

#### Neni 4: Objekti

Shoqeria do te kete per objekt kryesor te veprimtarise se saj:

- Instalime elektrike, projektimin, zbatimin dhe mirembajtje te rrjeteve e instalimeve elektrike, te tensionit te larte dhe te ulet, telefonike, televizive, radiofonike etj
- Import eksport dhe tregtimin e materialeve dhe paisjeve elektrike dhe elektronike, ndertime civile dhe industriale.
- Projekte elektrike
- Projektim dhe implementim i sistemeve te prodhimit te energjise se rinovueshme uji, dielli , era.
- Sistemet smart
- Ofrimi i rrjeteve dhe sherbimeve te komunikimeve elektronike
- Punime, germime, ndertime e rikonstruksione ne objekte civile dhe industriale.
- Projektim dhe Instalimi impianteve teknologjike, termike, hidrike, te ventilimit ftohje- ngrohjes (kondicionimit), furnizimit me gaz, i impianteve ngritese dhe transportuese (ashensore, shkallelevizese, transportues), te sinjalistikes rrugore.
- Projektim, instalim, operim dhe mirembajtje e sistemeve te prodhimit, prezantimit, transmetimit e monitorimit audio/vizual, TV, Radio, WEB-TV, IPTV, Hotel TV, Hospitality TV, A/V Conferencing, Analoge e Digjitale, Tokesore, Satelitore, Kablllore, TCP-IP
- Sherbime mirembajtje dhe servisi te ndryshem per materiale e pajisje elektrike, pajisje industrial e elektroshtepiake si dhe per pajisje dhe sisteme te ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe per impiante te tjera te çfaredo lloji ne vendet e ushtrimit te aktivitetit dhe jashte tyre ne objekte te ndryshme.
- Kryerjen e veprimtarise ne fushen e ndertimit, studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private
- Ndertimin e centraleve dhe objekteve turistike, objekteve te kultit, rrjetet inxhinierike, objektet industriale, te gjitha restaurimet, rikonstruksionet dhe mirembajtjet e godinave civile e industriale, veshjen e fasadave ne pergjithesi.
- Ndertimin dhe mirembajtjen e impianteve te prodhimit te energjise elektrike, ndertimet e nenstacioneve, kabinat e transformatoreve linja TN e te mesem dhe shperndarje te energjise, rikonstruksionin e veprave te artit, montimet e konstruksionet metalike si dhe çdo ndertim tjeter qe perben send te paluajtshem ne perfundim

-Gjithashtu, per te realizuar objektivat e saj, shoqeria mund te ndermarre e te zhvilloje edhe cdo lloj aktiviteti tjeter te ligjshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe qe siguron te ardhura dhe fitime te ligjshme.

- Objekti i shoqerise mund te zgjerohet apo zvogelohet ne varesi te interesave te shoqerise dhe ne baze te vendimit te asamblese se pergjithshme te ortakeve.

## **KAPITULLI II** **KAPITALI**

### **Neni 5 :**      **Kapitali themeltar**

5.1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 lek i formuar ne mase te plote nga kontributiet e ortakeve dhe i ndare ne dy kuota me vlere nominale sipas ndarjes se meposhtme. Cdo kuote njesie ka te drejten e nje vote. Pjesmarrja e themeluesieve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e secilit si me poshte:

Ortaket :

Z. Edmond Murja , zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 50 (pesedhjete)leke, qe perben 50% pjesmarrje te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z. Artur Pjeshka, zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 50 (pesedhjete)leke, qe perben 50% pjesmarrje te kapitalit themeltar te shoqerise

## **KAPITULLI III** **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

### **Neni 6**

**Organet kryesore drejtuese te shoqerise jane:**

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve
- Administratori


### **Neni 7**

#### **Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve** **Te drejtat dhe detyrimet**

7.1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

7.2. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;



- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji

7.3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### **Neni 8**

#### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme së Ortakeve**

8.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë drejtuar ortakeve të shoqërisë. Njoftimi me shkresë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

8.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 10.1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 9**

#### **Kuorumi**

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht dhe votojnë me shkresë.

c) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 10**

## Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

## Neni 11

### Administrimi

11.1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, të cilët duhet të jenë detyrimisht ortakë të saj. Afati i emërimit të administratorit është **5 vjet**, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare e Biznesit.

11.2. Administrator i parë i shoqërisë është **Z. Edmond Murja, i cili zgjidhet për një periudhë 5 vjecare.**

11.3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

## Neni 12

### Kompetencat e administratorëve

*Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:*

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

### **Neni 13**

#### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor nen juridiksionin e se cilit shtrihet aktiviteti i shoqerise.

### **Neni 14**

#### **Largimi i ortakut**

Ky statut nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakëve për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun ne baze te dispozitave perkatese te legjislacionit tregtar ne fuqi.

### **Neni 15**


#### **Dispozita perfundimtare**

Ne cdo rast, palet do ti referohen dispozitave ligjore te ligjit 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per zgjidhjen e ceshtjeve konkrete dhe te detajuara te cilat nuk jane permendur specifikisht ne kete akt themelimi personi juridik.

Ky statut u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi u miratua ne parim dhe nen per nen nga Ortaket e Shoqerise, u nenshkrua rregullisht pa asnje verejtje.

## **ORTAKET E SHOQERISE**

**EDMOND MURJA**



**ARTUR PJESHKA**

ARTUR PJESHKA

